



Periodik mujor Nr. 164 Janar 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Bilateralet Shqipëri-BE
për kapitullin 9-të
“Shërbimet Financiare”,
AMF organizon takimin përgatitor**

03-04

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

**Tregu i Sigurimeve, 2022
Tregu i Titujve të Qeverisë, 2022**

05-06

**BOTIME
PROFESIONALE**

**Global Risk Regulator
IAIS
OECD**

07-11

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

12-13

Bilateralet Shqipëri-BE për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, AMF organizon takimin përgatitor



Tiranë, 16 janar 2022 – AMF takim përgatitor për Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”



Në kuadër të kryesimit të kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” dhe përgatitjeve për Bilateralat Shqipëri-BE, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), organizoi takimin simulues për prezantimet e avancimeve ligjore e rregullatore për tregjet financiare me Direktivat Evropiane.

Takimi u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, në cilësinë e negociatorit të kapitullit 9 dhe në të ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve të tjera përgjegjëse, Banka e Shqipërisë (BSH), Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), si edhe ekspertë nga vendet e rajonit, të angazhuar me negociatat.

Anëtarët e grupit negociator paraqitën prezantimet kryesore që do të realizohen përpara ekspertëve të Komisionit Evropian në Takimin Bilateral më 13-14 shkurt 2023 në Bruksel, sa i përket shkallës së përafrimit të kuadrit ligjor që rregullon tregjet financiare në Shqipëri me legjislacionin dhe Direktivat Evropiane. Acquis në kapitullin 9 përfshin shërbimet financiare në fushën bankare, atë të sigurimeve, pensioneve private vullnetare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë.

Vijon ...

Bilateralet Shqipëri-BE për kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, AMF organizon takimin përgatitor

... Vijon

Komisioni Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, publikuar në tetor të vitit të kaluar, vlerëson përparimin e bërë me përafrimin ligjor e rregullator me acquis të BE-së dhe praktikat mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në konstatimet e kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, ku Autoriteti është institucioni lider, raporti nënvizon se “është bërë progres me sigurimet e detyrueshme dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Edhe Progres Raporti i vitit 2021 vlerësonte progresin e bërë në kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, në veçanti përmes miratimit të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit në mars të vitit 2021, si edhe masat e marra nga Autoriteti për garantimin e stabilitetit financiar të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë periudhës së pandemisë.

Komisioni Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, ... nënvizon se “është bërë progres me sigurimet e detyrueshme dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Në 7 tetor 2022, AMF kryesoi delegacionin shqiptar që mori pjesë në takimet shpjeguese për kapitullin 9 të negociatave “Shërbimet financiare”, organizuar në Bruksel nga Komisioni Evropian. Në këtë takim, ekspertët e Komisionit Evropian bënë një prezantim të direktivave dhe kërkesave që duhet të plotësojë Shqipëria për kapitullin 9. Në nëntor të vitit të kaluar, AMF në bashkëpunim me GIZ organizoi një workshop me pjesëmarrësit e Takimit Bilateral për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, në kuadër të përgatitjeve për prezantimet që do realizohen në 13-14 shkurt 2023 në Bruksel.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri në vitin 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-dhjetor 2022 kapën vlerën 21,033 milionë lekë, ose 9.16% më shumë se në janar-dhjetor 2021. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,325,231 me një rritje prej 12.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.75% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.01%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.84% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.16% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,830 milionë lekë, ose 2.39% më shumë se në periudhën janar-dhjetor 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-dhjetor 2022 kapën vlerën 4,445 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 11.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2022 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë vitit 2022 arritën rreth 13,073 milionë lekë, ose 10.06% më shumë se gjatë vitit 2021.

Ecunia e tregut me Pakicë të Titujve të Qeverisë për vitin 2022

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2022, u dominua në masën 50.52% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 49.48% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 80.01% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2022, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 67.77% dhe 18.96% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.06% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Transaksionet B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2022, ka pasur një rritje prej 3,668 milionë lekë ose 147.68% krahasuar me vitin 2021. Numri i transaksioneve i llojit B është rritur në masën 87.26%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2022, ka pasur një rritje prej 397 milionë lekë ose 14.54%, ndërkohë pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 13.13%, krahasuar me vitin 2021.


Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 4,066 milionë lekë, krahasuar me vitin 2021.



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.06% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.



Tregu i tituve të Qeverisë, viti 2022 (Në %)



SHBA drejt dollarit digjital, por ende ka hezitime

Subjects / Financial Markets

US moves closer to digital dollar, but reservations remain

Farah Khalique | January 9, 2023



The US is finally moving towards developing a digital dollar, after years of hesitation and discord. It could speed up payments and slash settlement risk in wholesale markets, but scepticism is still widespread.

Pas vitesh hezitimi dhe mosmarrëveshjes, SHBA po lëviz drejt zhvillimit të një dollari digjital. Megjithëse ka ende skepticizëm lidhur me të, dollari digjital mund të përshpejtojë pagesat dhe të ulë rrezikun e shlyerjes në tregjet me shumicë.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/US-moves-closer-to-digital-dollar-but-reservations-remain?ct=true>

Komiteti i Bazelit qartëson lidhur me kriptot, por bankierët mbeten të paqartë

Regions / Global

Basel Committee brings clarity to crypto, but bankers disappointed

Justin Pugsley | January 9, 2023



Banks now have a much clearer view over how they can interact with crypto-assets following the Basel Committee on Banking Supervision rolling out its final crypto standards. Though it reduces regulatory uncertainties, banks were largely disappointed.

Bankat tani kanë një pamje shumë më të qartë se si mund të ndërveprojnë me kripto-asetet. Kjo pasi Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare ka nxjerrë standardet e tij përfundimtare të kriptove. Megjithëse, pavarësisht se kjo zvogëlon pasiguritë rregullatore, bankat mbeten të paqartë.

<https://www.globalriskregulator.com/Regions/Global/Basel-Committee-brings-clarity-to-crypto-but-bankers-disappointed?ct=true>



Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, nxori dy botime mbi inovacionin digjital:

- Raport i IAIS mbi zhvillimet FinTech në sektorin e sigurimeve;
- Shënim i përbashkët me Inicativën për Akses në Sigurime (A2ii) dhe Institutin e Stabilitetit Financiar (FSI) të Bank for International Settlements, BIS, mbi rolin e teknologjisë mbikëqyrëse, SupTech në mbikëqyrjen e sigurimeve

Raporti i IAIS mbi zhvillimet FinTech në sektorin e sigurimeve

Duke pasur parasysh inovacionit digjital në teknologjinë financiare “FinTech” dhe efektet e saj të gjera në sektorin e sigurimeve, Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, ka identifikuar FinTech si një nga temat e saj strategjike. FinTech paraqet mundësi të rëndësishme për përfshirjen financiare edhe për zotëruesit e policave të sigurimeve. Ai gjithashtu krijon mundësi për rreziqe operationale, kjo për shkak të zgjerimit të shpejtë të të dhënave nga burimet alternative dhe analizat e avancuara të këtyre të dhënave, të cilat kanë potencialin të prishin tregun e sigurimeve ose të ndikojnë në besimin e konsumatorëve në sektor.

IAIS përdor Forumin FinTech si një platformë për të ndarë perspektivat mbikëqyrëse, sfidat dhe zhvillimet në lidhje me teknologjinë financiare. Duke filluar nga viti 2021, Forumi FinTech ka kryer vlerësime të thelluara në tre tema:

- Përdorimi i ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API) dhe të dhënave të hapura;
- Teknologjitë e Librave të Shpërndara (DLT) dhe blockchain; si edhe
- Adoptimi i sigurt, i drejtë dhe etik i Inteligjencës Artificiale (AI) dhe Mësimi i Makinerisë (ML), përdorimi dhe qeverisja e të dhënave.

Vlerësimet përfshijnë të dhëna të mbledhura përmes anketave të anëtarëve dhe intervistave me pjesëmarrësit e tregut dhe ekspertët. Qëllimi i vlerësimeve të thelluara ishte të kuptohej më mirë peizazhi aktual i transformimit digjital, të identifikoheshin çështjet dhe tendencat në fusha specifike dhe të vlerësoheshin implikimet e tyre të mundshme për mbikëqyrjen e sigurimeve.

Raporti i IAIS mbi zhvillimet FinTech në sektorin e sigurimeve, Dhjetor 2022 [IAIS Report on Fintech](#)

... vijon

Ky raport paraqet gjetjet e nivelit të lartë të këtyre vlerësimeve për qëllime informative. Ai nuk synon të paraqesë një vlerësim përfundimtar mbi rreziqet dhe mundësitë e këtyre tendencave. Raporti nuk synon të deklarojë ndonjë preferencë të caktuar, pasi IAIS ka një qasje neutrale ndaj teknologjisë. IAIS do të vazhdojë të monitorojë këto tendenca dhe ndikimin e tyre tek siguruesit, konsumatorët dhe objektivat e mbikëqyrjes

Shënim i përbashkët A2ii FSI IAIS mbi SupTech

Duke konsideruar rëndësinë në rritje të rolit të teknologjisë mbikëqyrëse “SupTech”, mbikëqyrësit në sigurimeve shohin nevojën për të kuptuar qartë potencialin e SupTech për të ndihmuar punën e tyre. Ky shënim synon të kontribuojë në këtë kuptim duke përmendur shembuj konkretë se si mjetet SupTech përdoren nga 22 mbikëqyrës sigurimesh. Ai i përshkruan këto mjete, të cilat klasifikohen sipas përdorimit të tyre të synuar, qoftë për mbikëqyrje të kujdesshme, ose të sjelljes së tregut, ose edhe për të dyja. Në këtë shënim pasqyrohet një gjetje se mjetet SupTech të përdorura nga mbikëqyrësit e sigurimeve për mbikëqyrjen e kujdesshme janë të ngjashme me ato të përdorura nga mbikëqyrësit bankarë. Nga ana tjetër, shumica e mjeteve të përdorura për sjelljen e tregut, janë specifike për sektorin e sigurimeve.

Ndërkohë, shumica e mjeteve që mund të përdoren si për mbikëqyrjen e kujdesshme ashtu edhe për sjelljen e tregut kanë të bëjnë me mbledhjen e të dhënave. Në vazhdim, shumë mbikëqyrës sigurimesh po synojnë në mënyrë specifike të zhvillojnë sisteme të integruara dhe aplikacione të ndryshme që mbulojnë të gjithë procesin e mbikëqyrjes.

IAIS do të vazhdojë të monitorojë këto tendenca dhe ndikimin e tyre tek siguruesit, konsumatorët dhe objektivat mbikëqyrëse.

Shënim i përbashkët
A2ii FSI IAIS mbi
SupTech
[Joint A2ii FSI IAIS Note
on SupTech](#)



Në nëntor 2021, kripto-asetet arritën një kulm në vlerësimin e tyre. Por pas saj, ky treg hyri në një periudhë të zgjatur rënieje. Çmimi i kripto-aseteve kryesore Bitcoin (BTC) dhe Ether (ETH) ra ndjeshëm. Nga mesi i qershorit i gjithë tregu i kripto-aseteve humbi 1.7 trilionë dollarë në vlerën e tregut, në krahasim me kulmin e tij dhe protokollat DeFi (Financat e Decentralizuara) ndoqën një model të ngjashëm, me vlerën totale të kripto-aseteve në DeFi (TVL) duke rënë me më shumë se 65% në një periudhë gjashtëmujore, deri në maj 2022.

Rënia e çmimeve të kripto-aseteve, krahas rënies më të gjerë të tregut për asetet me risk, tregon ndërlidhjen e këtyre tregjeve me klasat tradicionale të aktiveve me rrezik.

Shitja fillestare ndodhi në sfondin e pritjeve për inflacionin në fund të 2021 dhe fillimin e 2022, që përkon me një rritje të çmimeve të arit. Kjo tregoi më tej se perceptimi i investitorëve për kripto-asetet si Bitcoin, si mbrojtje të inflacionit nuk mund të justifikohet.

Rënia në vlerësimet e aseteve kryesore të kriptove shkaktoi dështime të firmave të kripto-aseteve, të cilat nga ana e tyre e intensifikuan më tej dhe e përkeqësuan shitjen e kripto-tregut. Efekti domino që u shkaktua nga një kombinim i dështimeve të firmave të kripto-aseteve (siç është dështimi i të ashtuquajturit stablecoin i UST Terra) në sfondin e një rënieje të zgjatur të tregut të kripto-aseteve (i njohur si "dimër kripto"). Në gjashtëmujorin e parë 2022 këto situata kanë pasur një ndikim të rëndë në shumë pjesëmarrës të tregut të kripto-aseteve të shitjes me pakicë, të cilët mund të kenë pësuar humbje të konsiderueshme të investimeve pa asnjë rekurs.

Vijon ...

[Lessons from the crypto winter: DeFi versus CeFi \(oecd-ilibrary.org\)](https://oecd-ilibrary.org)

"Dimri i kriptove" - Rënia e tregut të aseteve krypto

... vijon

Humbjet e investitorëve me pakicë duhet të konsiderohen gjithashtu në dritën e vëzhgimit se shumë investitorë të mëdhenj të aseteve krypto ("balenat krypto") ose pjesëmarrës dominues të tregut thuhet se mbyllnin pozicione me humbje të kufizuara apo edhe një fitim. Bazuar në një raport të industrisë, disa investitorë të mëdhenj dukej se kishin dalë nga pozicionet e tyre në UST shumë më herët se shumë investitorë më të vegjël, ndërsa disa investitorë të vegjël gjithashtu vazhduan të blinin gjatë kolapsit. Duhet të theksohet se provat në këtë shënim që përshkruajnë incidentet e ndodhura gjatë "dimrit të kriptove" bazohen në burime të industrisë dhe media të specializuara dhe nuk janë shqyrtuar në mënyrë të pavarur nga OECD. OECD ka kryer gjithashtu analiza të të dhënave të ofruara nga firmat analitike të blockchain. Incidentet e raportuara nuk mund të vërtetohen me siguri, për shkak të mungesës së transparencës në lidhje me transaksionet e ndërmarra nga pjesëmarrësit në shkëmbimet e decentralizuara ose ato reciproke midis pjesëmarrësve. Këtu ndikon edhe rrezikshmëria e transaksioneve të tilla, e shoqëruar me natyrën e fshehur nën pseudonime të shumë transaksioneve të krypto-aseteve dhe vështirësia që pason për të gjurmuar kuletat e pronarëve.



Mësime nga dështimet e mëdha

Rritja dhe rënia e "stablecoin" algoritmik TerraUSD (UST) në një hark kohor të shkurtër dhe dështimet e njëpasnjëshme të ofruesve të tjerë të shërbimeve krypto-asete (Celsius, Three Arrows Capital dhe dështimi më i madh, FTX) ekspozoi pasojat e gjera të ndërlidhjes brenda hapësirës së krypto-aseteve.

Këto ngjarje qartësuan ndërlidhjen e madhe brenda tregjeve të krypto-aseteve dhe potencialin e krijimit të kanaleve të transmetimit në tregjet tradicionale. Shpërthimi UST theksoi rolin e madh të besimit në tregun e krypto-aseteve, i ngjashëm me rëndësinë që ka besimi edhe në tregjet financiare tradicionale dhe se si një humbje e mprehtë e besimit mund të ndikojë në ekosistemin e krypto-aseteve.

Dështimet e fundit ekspozuan gjithashtu fragmentimin e mundshëm dhe asimetritë informative midis shkëmbimeve të decentralizuara (DEX) dhe shkëmbimeve të centralizuara (CEXs), gjë që u jepte përparësi atyre që tregtojnë në DEX në dëm të investitorëve të pa sofistikuara ose me pakicë.

[Lessons from the crypto winter DeFi versus CeFi \(oecd-ilibrary.org\)](https://oecd-ilibrary.org)

Materiali është marrë me shkurtime nga "Përmbledhja Ekzekutive" e botimit në faqen e OECD

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuar në faqen zyrtare *online* të Komisionit Mbikëqyrës Financiare të Bullgarisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto për 9-mujorin e vitit 2022 në tregun bullgar të sigurimeve arriti në 2.64 miliardë BGN ose rreth 1.35 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 8.44% në terma vjetorë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 0.79% duke arritur në 442.68 milionë BGN, ndërsa për siguresit e Jo-Jetës ato u rritën me 10.12%, duke arritur në 2.20 miliardë BGN.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundit të shtatorit 2022, të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, CNB, tregu çek i sigurimeve e mbylli tremujorin e tretë të 2022 me prime të shkruara bruto me vlerë 151.47 miliardë CZK, ose rreth 6.17 miliardë euro. Kjo shifër shpreh një rritje me 12.55% më shumë se në të njëjtën periudhë të një vit më parë.

Dëmet e paguara nga siguresit vendas arritën në 87.55 miliardë CZK, ose rreth 3.56 miliardë euro, me rritje prej 15.93 krahasuar me një vit më parë. Dëmet e paguara lidheshin 60% me sigurimet e Jo-Jetës dhe 40% lidheshin me sigurimet e Jetës.

Për segmentin e Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto (përfshirë risigurimin) u rrit me 4.35% duke arritur në 41.09 miliardë CZK. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto totale të nënklasave të Jo-Jetës arritën në fund të shtatorit 2022 rreth 110.38 miliardë CZK, me rritje me 15.94% krahasuar me një vit më parë.

MAQEDONI E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprahe të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut, siguruesit maqedonas realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto për nëntëmujorin 2022 me vlerë 9.59 miliardë denarë, ose rreth 156 milionë euro. Kjo shifër shënon një rritje prej 8.67% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës përbën rreth 83.77% të vëllimit total të primeve me afërsisht 130.68 milionë euro, duke shënuar rritje me 7.12% në terma vjetore. Peshën më të madhe e zinin sigurimi MTPL, me 41.18% të totalit, prona me 17.40%, sigurimi Kasko me 7.57%. Sigurimet e Jetës zinin 16.23% të primeve në total duke realizuar 25.32 milionë euro dhe me rritje prej 17.46% në terma vjetore.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara në faqen e Internetit të Bankës Kombëtare të Serbisë, NBS, tregu serb i sigurimeve e mbylli nëntëmujorin e vitit 2022 duke realizuar një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë rreth 847 milionë euro. Kjo shifër shënon rritje me 12.20% e shprehur në terma vjetore. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 14.31% në terma vjetore, duke arritur në 79.17 miliardë dinarë, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës arriti në 20.22 miliardë dinarë, duke u rritur me 4.64% në terma vjetorë.

Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 20.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 45.03 miliardë dinarë ose rreth 384 milionë euro. Pjesën më të madhe të dëmeve të paguar e zinin ato lidhur me kontrata të sigurimit të Jo-Jetës, me 31.41 miliardë dinarë, që shënonin një rritje me 24.71% në terma vjetore. Pagesat e dëmeve për klasat e Jetës zinin 13.62 miliardë dinarë, duke shënuar edhe këto një rritje me 12.11%.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave 9-mujore të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë (NBS), tregu sllovak i sigurimeve arriti në 1.43 miliardë euro, ose rreth 10.55% më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Segmenti i sigurimeve të Jetës ra me 12.69% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021 duke arritur në 586.19 milionë euro. Ndërsa sigurimet e Jo-Jetës përbënin 59.26% të primeve të shkruara bruto totale, me një vlerë 852.78 milionë euro, ose 9.02% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2021.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas ra me 1.92% në terma vjetorë, duke arritur në 847.40 milionë euro.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al